



PLANIFIKIMI PËR NJË ORË MËSIMORE TË SUKSESSHME PËR TU APLIKUAR NË MËSIMIN E KOMBINUAR



Dr. Lediana Xhakollari



Cilat janë
pritshmeritë tuaja
mbi këtë webinar?



Krijimi i aftësive profesionale për planifikimin dhe hartimin e një ore mësimore online/në distancë të mësuesit dhe instruktorët e Institucioneve ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional.

**UDHËZUES
PËR
ORGANIZIMIN
E MËSIMIT NË
ARSIMIN
PROFESIONAL
NË KUSHTET
E PANDEMISË
COVID-19**

VITI SHKOLLOR
2020/2021

3 skenarët e procesit mësimor 2020-2021

A. Mësim
në shkollë

B. Mësim i
kombinuar

C. Mësim
në
distancë

Sknenari B

- Nxënësit zhvillojnë një pjesë të procesit mësimor në mjedise arsimore dhe pjesën tjetër online dhe/ose në biznes
- Shkollat, sipas një analize në drejtori dhe nivel departamenti/ekipi lëndor, marrin vendimin mbi çfarë mund të zhvillohet në institucion dhe çfarë online.
- Sipas burimeve fizike e njerëzore në dispozicion, mësimi në shkollë mund të zhvillohet me turne dhe orë të shkurtuara 30 min.
- Prioritet të zhvillimit në institucion duhet t'u jepet maturave dhe klasave tjera, në përfundim të të cilave merret çertifikatë niveli.
- Në kushtet e disponibilitetit të burimeve, prioritet ka mësimi në mjedise shkollore/biznese.
- Pavarësisht nga forma e zgjedhur për zhvillimin e mësimi, mësuesi parashikon takime në shkollë me nxënësit të paktën një herë në 4 javë.
- Sugjerohet që të zhvillohen sa më shumë të jetë e mundur në shkollë lëndët që janë subjekt i provimeve të nivelit apo të maturës.

Sugjerohet të zhvillohen online:

- lëndët që nuk janë pjesë e programeve orientuese të provimeve të nivelit apo të maturës,
- lëndët për të cilat ka/mund të hartohen materiale mësimore digjitale,
- lëndët, mësuesit e të cilave shprehin gatishmëri, kanë infrastrukturën e nevojshme, janë të trajnuar ose të gatshëm për t'u trajnuar për mësimin në distancë, kanë akses dhe përdorin platforma për menaxhimin e mësimit online bashkë me nxënësit,
- veprimtari mësimore për nxënësit që nuk frekuentojnë dot për shkak të gjendjes shëndetësore.



Modulet e praktikës:

- të zhvillohen në repartet e punës, laboratorë apo mjedise tjera praktike në shkollë, në kushtet kur janë të domosdoshme pajisje të caktuara,
- të zhvillohen me grupe të ndara kur zhvillohen në shkollë,
- të zhvillohen sa më shumë në biznes, duke respektuar rregullat e MSHMS dhe kushtet më poshtë,
- mund të zhvillohen më shumë online/në distancë në drejtime si ekonomi biznes, TIK etj., apo në rastet ku mund të realizohen me projekte,
- të cilat synojnë mësimin e programeve aplikative në kompjuter, të realizohen pjesërisht në distancë (për nxënësit që kanë akses në teknologji) dhe për të tjerët në laboratorët TIK në shkollë,



Organizimi i modulit



- 1) Komponentët e planit mësimor
- 2) Hapat për përgatitjen e planit mësimor.





- 1) Planet mësimore me tri pjesë (të përditësuara për mësimin online)
- 2) Përdorimi i videos në mësimin online.



- 1) Përshtatja e planit mësimor për mësimin e kombinuar dhe në distancë
- 2) Këshilla mbi planifikimin e mësimit online
- 3) Sfidat që priten dhe si kapërcehen.

Cilat janë pjesët kryesore të një plani mësimor?







A duhet mësuesi ta prezantojë planin mësimor ditor tek nxënësit?

Çfarë mund të bëhet nëse mësuesi evidenton se plani mësimor nuk ka funksionuar siç duhet?

A duhet të parashikojë plani mësimor përgjigjen ose pyetjen e secilit nxënësi?

A duhet mësuesi ta prezantojë planin mësimor ditor tek nxënësit?

I ndihmon të jenë më të angazhuar dhe në rrugën e duhur & kujtojnë më mirë

Çfarë mund të bëhet nëse mësuesi evidenton se plani mësimor nuk ka funksionuar siç duhet?

Merr feedback: reagimet e nxënësve, vëzhgime i kolegëve, shikimi i një videokasetë të mësimdhënies tuaj, konsultimi me specialist arsimit etj.

A duhet të parashikojë plani mësimor përgjigjen ose pyetjen e secilit nxënës?

Një mësim produktiv nuk është ai në të cilin gjithçka shkon saktësisht siç është planifikuar, por një në të cilën të dy, edhe nxënësi edhe mësuesi mësojnë nga njëri-tjetri.

Skica të planit mësimor ditor

Fusha	Lënda:	Shkalla:	Klasa:	Dt
Tema mësimore:		Situata e të nxënit:		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:		
Burimet:	Mjetet:	<i>Lidhje me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:</i>		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimi:				
Vlerësim:				
Data:				

FORMATI 1

- Lënda
- Kapitulli
- Tema
- Objektivi i përgjithshëm/standardi lëndor i përmbajtjes që duhet përmbushur
- Objektivat specifike
- Fjalë kyç/konceptet më të rëndësishme
- Procedura
- Materialet e nevojshme
- Detyrat e shtëpisë

FORMATI 2

- Tema e mësimi Data
- Kapitulli Klasa
- Objektivat e mësimi
- Përmbajtja
- Procedura
- Materialet mësimore
- Vlerësimi

FORMATI 3

- Mësuesi Klasa Data
- Kapitulli
- Objektivat
- Përmbajtja Shënime
- Procedurat
- Vlerësimi dhe pyetje
- Detyrat e shtëpisë
- Materialet mësimore

HAPAT PËR PËRGATITJEN E PLANIT MËSIMOR

*Përshkruaj
rezultatet
e të nxënit*

*Zhvillo
hyrjen*

*Planifiko
aktivitete
specifike
mësimore*

*Planifikoni
të
kontrolloni
të
kuptuarit*

*Zhvilloni
një
përfundim
dhe një
pamje
paraprake*

*Krijoni një
afat kohor
realist*

Përshkruaj rezultatet e të nxënit

- Cila është tema e mësimit? Çfarë dua të mësojnë nxënësit? Çfarë dua që ata të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë në fund të orës? Çfarë dua që ata të përfitojnë nga ky mësim i veçantë?

Zhvillo hyrjen

- Si do të kontrolloj nëse nxënësit dinë diçka në lidhje me temën ose kanë ndonjë nocion të paramenduar në lidhje me të? Çfarë do të bëj për të prezantuar çështjen?

Planifiko aktivitete specifike mësimore

- Çfarë do të bëj për të shpjeguar temën? Çfarë do të bëj për të ilustruar temën në një mënyrë tjetër? Si mund t'i angazhoj nxënësit në temë? Cilët janë shembujt e jetës reale, analogjitë ose situatat e përshtatshme që mund t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë temën?
- Çfarë do të duhet të bëjnë nxënësit për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë temën?

Planifikoni të kontrolloni të kuptuarit

- Cilat pyetje do t'u bëj nxënësve për të kontrolluar të kuptuarit? Çfarë do të bëj që nxënësit të demonstrojnë se po më ndjekin?
- Duke par listën time të rezultateve të të nxënit, çfarë aktiviteti mund të bëj për të kontrolluar nxënësit nëse secila prej tyre është përmbushur?

Zhvilloni një përfundim dhe një pamje paraprake

- Përmbledhen pikat kryesore & i hidhet një vështrim paraprak mësimit vijues

Krijoni një afat kohor realist

- Vlerësoni se kohë do të marrë secila nga aktivitetet, pastaj planifikoni pak kohë shtesë për secilën. Kur përgatisni planin tuaj të mësimit, pranë çdo aktiviteti tregoni se sa kohë prisni që të marrë. Planifikoni disa minuta në fund të orës për t'iu përgjigjur çdo pyetje të mbetur dhe për të përmbledhur pikat kryesore.
- Planifikoni një aktivitet shtesë ose pyetje diskutimi në rast se ju mbetet kohë.
- Jini fleksibël- jini të gatshëm për të përshtatur planin tuaj të mësimor me nevojat e nxënësve dhe përqendrohuni në atë që duket më produktive sesa të qëndroni në planin tuaj original.

The words "QUIZ TIME" are written in a large, white, bold, sans-serif font. The text is centered and overlaid on a background of vibrant, multi-colored brushstrokes. The colors include shades of blue, purple, pink, red, orange, yellow, and green, creating a dynamic and energetic feel.

QUIZ TIME

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc_DQLAbdUt8VWEx-u6F2VL3TEx1h_2GoUTqEq_taXkmnnUVg/viewform?usp=sf_link



Planet mësimore me tri
pjesë, angazhuese dhe
efektive (të përditësuara
për mësimin online)



Mësuesi:	Klasa:	Njësia:	Data:	Totali i minutave:
Standardi/et:_____ Rezultatet e të nxënit: _____ Materialet:_____				
Vlerësimi: Si do ti matni rezultatet e mësimit?				
Pjesa 1: Frymëzo dhe angazho (10-20 minuta)				
Nxënësit bëhen gati për sukses. Aktivizoni njohuritë paraprake, gjeneroni interes dhe komunikoni pritshmëritë (Lojë, mini-mësim, praktikë e drejtuar, video etj)				
Aktiviteti A _____ Kohëzgjatja në minuta _____ Përshkrimi:				
Pjesa 2 Workshop (30-45 minuta)				
Fokusi kryesor i orës së mësimit, ku nxënësit mësojnë duke bërë. Hyrja përcakton aktivitetet por të mësuarit zhvillohet gjatë workshopit				
Hyrje: Si do ti komunikoni aktivitetin, burimet dhe pritshmëritë?				
Lehtësimi: Si do ti ndihmoni nxënësit dhe të kontrolloni për të kuptuarit?				
Diferencimi: Si do të grupohen nxënësit? A do të modifikoni aktivitetin për grupe të ndryshme?				
Pjesa 3 Ndarja dhe reflektimi				
Çimentimi i mësimit të ditës, dhe kontekstualizmi, kontrolli për të kuptuarin (Aktivitete të sugjeruara: ditari, sondazhi, diskutimi, detyrë shtëpie etj)				
Aktiviteti A _____ Kohëzgjatja në minuta _____ Përshkrimi:				



• ANGAZHIMI NË MËSIMET ONLINE

Ndarja në grupe: Filloni mësimet tuaja në internet me një angazhim të shkurtër dhe frymëzoni të gjithë grupin. Më pas ndani nxënësit në grupe për aktivitetet praktike. Programoni oraret e kontrollit për secilin grup dhe lidhuni përsëri të Ndarë dhe për të Reflektuar.

Dokumente bashkëpunuese: Paketa Google Drive. Krijoni Google Doc të përbashkët, Google Slides, Sheets Drawings

Letra digjitale: Disa aktivitete thjesht duken më mirë në letër. Ju mund t'i ktheni materialet në Pdf

PËRDORIMI I VIDEOS NË MËSIMIN ONLINE

■ *Përdor kamerën në avantazhin tënd*

Kamera është miku juaj!

Nëse mund të integroni kamerën tuaj me kamerat e nxënësve të tjerë në planin tuaj mësimor, klasa juaj do të ketë një ndjenjë shumë më të fortë grupi.

P.sh., mësuesi mund të bëjë pyetje të cilave nxënësit mund tu përgjigjen vizualisht.

Mësuesit mund tu kërkojë nxënësve të vizatojnë një figurë ose të shkruajnë fjalë apo ekuacione dhe ta mbajnë letrën të drejtuar nga kamera.



Cilën mënyre preferoni
personalisht të përdorni
për mësimin online?

- a)mësimin me video live
- b) mësimin e regjistruar

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeYRLDuQf-vxMEm4cWx8-wfrzTpkYiksN4Q-DoK0V7Ubg1uEOw/viewform?usp=sf_link



PËRDORIMI I VIDEOS NË MËSIMIN ONLINE

- *Videot Live vs të regjistruara*

Cila prej tyre është më e
dobishme??



Mësimet me video live

Shumica e mësuesve janë jo shumë rehat me këtë format për shkak të paqartësive dhe kompleksiteteve në mjediset live.

Ju e dini se sa nxënës ju kanë ndjekur.

U jep komfort nxënësve duke ju parë dhe dëgjuar.

Prindërit gjithashtu kanë nevojë të shikojnë dhe dëgjojnë se si ju jepni mësim.

Zoom/ Google Meet/ YouTube Live/
Facebook Live



Mësimet e regjistruara

Krijojnë mundësinë për të qenë “prezent” dhe për të angazhuar nxënësit tuaj sikurse do të bënit në klasë, pa pasur nevojën për të përfshirë secilin një të njëjtën dhomë virtuale në të njëjtën kohë.

Janë mësimet më të kontrolluara dhe nxënësit mund të shikojnë, ndalojnë sa herë që ata të kenë nevojë.



PËRDORIMI I VIDEOS NË MËSIMIN ONLINE

■ ***Këshilla për mësimet video***

Shumica e nxënësve (dhe të rriturve) nuk kanë një periudhë të gjatë të vëmendjes.

Rekomandohet që mësuesit të përziejnë mësimin me pjesë argëtuese për ta mbajtur atë interesant (p.sh., mund të tregosh një pikturë apo fotografi, mund të bësh ndonjë humor të vogël).

E pritura dhe e papritura i mban nxënësit të angazhuar dhe mirënjohës për përpjekjet e mësuesit.



PËRDORIMI I VIDEOS NË MËSIMIN ONLINE

■ *Këshilla për mësimet video*

“Kur jep mësim me leksione të regjistruara... bëj pyetje dhe flit sikur të ishit realisht me nxënësit. Pavarësisht se ju duhet tu përgjigjeni vetë pyetjeve tuaja, ngrini pyetje dhe bëni një pauzë për ti lënë nxënësit që të mendohen”.

Një skicë është ideale dhe siguron ende një farë spontaniteti dhe energjie (Jo lexim)



PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR MËSIMIN E KOMBINUAR DHE NË DISTANCË

Mësuesit duhet të jenë fleksibël dhe të gatshëm të provojnë formate, aplikacione dhe faqe të reja interneti.

Nëse nuk funksionin, provo diçka tjetër.

Vetëm sepse diçka funksionon, nuk do të thotë se gjithmonë duhet të përdorni atë mjet ose aktivitet.





PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR MËSIMIN E KOMBINUAR DHE NË DISTANCË

Nxit kreativitetin tënd

- Përkufizoni me 2-3 fjalë qëllimin e mësimit
- Mendoni për disa nga idetë më të mira apo të çmenduara dhe shkruajini në një letër
- Mos vendos dy aktivitetet të ngjashme njëri pas tjetrit
- Mos u fokusoni në ushtrime të mërzitshme, por në praktika me substance
- Krijoni hapje dhe mbyllje të forta dhe që mbahen mend
- Lini kohë për pyetjet dhe diskutimin e pa drejtuar



PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR MËSIMIN E KOMBINUAR DHE NË DISTANCË

Nxit kreativitetin e nxënësit

- Mendoni për mënyra si të përfshini nxënësit në procesin e të nxënit duke planifikuar aktivitete që u kërkojnë atyre të marrin pjesë.



PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR MËSIMIN E KOMBINUAR DHE NË DISTANCË

Nxirr më të mirën


- Luani disa video të shkurtra mbi temën
- Siguroni imazhe
- Tregoni burimet e informacionit
- Përdor ngjyra



PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR MËSIMIN E KOMBINUAR DHE NË DISTANCË


Përziej dhe bashko të vjetrën me të
renë

- Mendoni për mënyra për të
përshtatur ushtrimet dhe lojërat
tuaja të preferuara në mënyrë që t'i
përdorni ato në mjedisin virtual.



KËSHILLA MBI PLANIFIKIMIN E MËSIMIT ONLINE





Identifiko rezultatet e të nxënit dhe shkathtësitë (aftësitë) përbërëse

Ndryshoni llojet e veprimtarive

Vetë reflektimi

Shfrytëzoni Modele (template) e planit mësimor online

Stimuloni diskutimet

Planifikoni të mbuloni më pak material

Theksoni komunikimin e rregullt

SFIDAT QË PRITEN DHE SITË KAPËRCEHEN





SFIDAT QË PRITEN DHE SITË KAPËRCEHEN

- Një plan rezervë ose B
- Duhet të jeni të përgatitur me tema apo çështje të tjera për diskutim
- Duhet të jeni të hapur ndaj sugjerimeve, por kjo nuk do të thotë që ju duhet të ndryshoni plotësisht gjithçka.
- Provoni gjëra të reja mundësisht disa herë. Gjeni atë që funksionin për stilin tuaj të mësimdhënies dhe jo thjesht atë që është më popullore
- Duhet të jeni të ndjeshëm ndaj nxënësve të turpshëm dhe ta pranojnë



Përfitimet e planifikimit të mësimit në klasën virtuale

- Duke organizuar elementët e mësimit ju mund të siguronit se ato nuk janë përsëritëse, por komplementare me njëra tjetrën.
- Ajo mundëson që paraprakisht të mendoni për mënyrën më të mirë për të prezantuar materialin më të rëndësishëm.
- Ju mund të llogarisni kohën për lojërat, këngët dhe aktivitetet e tjera që ndihmojnë procesin e të nxënës.
- Ai siguron strukturën më të mirë për të përfshirë lehtësisht nxënësin në temë
- Ai ju jep kohë të mendoni për formatin e mësimit dhe të nxirrni ide të reja.

Faleminderit



Lediana Xhakollari



0672220416



lxhakollari@gmail.com